Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

përrjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit¹

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht¹;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4/1

b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;

c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;

ç. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 11/1

d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit.

Objekti i prokurimit (*projektim*) duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Përsa i përket kapacitetit ekonomik e financiare, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale:

2.2.1 Xhiro mesatare financiare vjetore pa TVSH, e realizuar nga Operatori Ekonomik përkatesisht në tre vitet e fundit 2017, 2018 dhe 2019, lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit ose 16.520.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë pa tvsh.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqeruara me akt ekspertizen e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar, vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të ligjit nr.10091, date 05.03.2009

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 dhe 2020 sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga institucioni përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e punëve të ngjashme:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar kontrata për shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 16.520.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë pa tvsh, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka në dispozicion burime njerëzore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, numri

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

mesatar i të punësuarve duhet të jetë jo më pak se 20 (njëzetë) punonjës, për periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave), të vërtetuar me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar edhe me Formularët e Deklarimit të Pagesave (*me nënshkrim elektronik ose në hard copy*)

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar me përvojë pune të ngjashme në projektim dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave), si më poshtë:

Stafi kryesor për shërbimin e projektimit

1. 1 Projektues Elektrik;
2. 1 Projektues Inxhinier Elektronik
3. 1 Projektues Rruge
4. 1 Projektues Arkitekt/Urbanist
5. 1 Projektues Gjeodet

Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës si më sipër për kryerjen e të gjitha shërbimeve, si më poshtë:

- a) Stafi i mësipërm duhet të të kenë realizuar të paktën 2 (dy) projekte të ngjashme;
- b) Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale për stafin kryesor, operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencat përkatëse, diplomat, CV dhe kontratat e punës.

Stafi ndihmës për shërbimin e projektimit

- a. Inxhinier Elektrik 3 Persona të certifikuar për sistem automatizimi Smart City.
- b. Inxhinier Elektrik 3 Persona të certifikuar për software llogaritës të studimeve fotometrike sipas standartit EN-13201

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale për stafin ndihmës duhet të paraqiten diplomat, CV, certifikatat dhe kontratat e punës apo marreveshjet e bashkëpunimit.

2.3.4 **Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:**

Operatori ekonomik duhet të disponojë liçensë profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislationit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit), ku të përfshihen kategoritë:

Kategoria 1. PROJEKTIM URBANIST

c- Plane të detajuara vendore.

Kategoria 2. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

Kategoria 4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial.

g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive,

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

porteve aeroportive etj.

Kategoria 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

c- Autostrada.

Kategoria 8. PROJEKTUES GJEODET PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a- Rivelime inxhinierik.

d- Bazamente gjeodezike.

c- Sisteme GIS.

d- Bazamente gjeodezike.

e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Kategoria 10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

c- Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.

d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë.

e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

Kategoria 11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

b- Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet te ekuivalentoje (njesoje), licensen profesionale qe disponon, te leshuar nga vendi i origjines, prane institucioneve të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale.

***Operatorët Ekonomike** duhet të paraqesin ne baze te Njoftimit të Agjensise se Prokurimit Publik dt 25.07.2017 nje analize te cmimit të paraqitur, duke specifikuar sakte të gjithë elementet që kanë marrë parasysh në llogaritjen e cmimit, si dhe duke plotësuar të gjitha kerkesat e VKM 354 date 11.05.2016 si dhe aktet ligjore ne fuqi*

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Shtojca 11/1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Shtojca 14

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”**

Afatet e ekzekutimit: Afati kohor i realizimit të studim-projektimit 8 (tetë) muaj.

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Shtojca 15

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

”STUDIM MASTERPLANE NDRICIMIT TË QYTETIT”

Bashkia e Tiranës, me fondin 49,560,000 lekë me tvsh, kërkon të realizojë studim Masterplane ndricimit të qytetit, në qytetin e Tiranës për objektin: “**Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit**” me vlerë paraprake të zërit ndërtim – montim 3.000.000.000 lekë me TVSH.

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Zhvillimi i teknologjive të prodhimit të burimeve artificiale të ndricimit LED (Light-Emitting Diode), ndriçuesve dhe sistemeve të monitorimit dhe kontrollit të tyre, në dekadën e fundit kanë ofruar zgjidhje që përmirësojnë ndjeshëm eficientë energjitike të sistemeve të ndricimit rrugor, prodhojnë një ndriçim më të pastër, të kontrolluar e të monitoruar në distancë, jetëgjatë, estetishtë të këndshëm, pa ndotje dhe të lehtë në mirëmbajtje.

Përballë kësaj kërkesë globale të profesionizmit të dizanjit të ndricimit, Bashkia e Tiranës kërkon që të njihet me nga afër me mundësinë e aplikimit të këtyre sistemeve të reja në territorin e saj me qëllim hartimin e një masterplani për të ardhmen e ndriçimit rrugor në territorin e saj administrativ.

Masterplani që do hartohet do ketë si qëllim të studiojë mundësitë dhe të japë rekomandime për zhvillimin dhe instalimin e teknologjive LED në ndriçimin rrugor të Bashkisë Tiranë.

Masterplani ka për qëllim gjithashtu dhënien e rezultateve të përmirësuar të ndriçimit publik, duke përfshirë përmirësimin dhe efikasitetin e energjisë si dhe uljen e kostove të vazhdueshme përmes përdorimit të teknologjive të reja LED.

Hartimi i këtij masterplani është I rëndësishëm sepse me anë të ndriçimit ne krijojmë:

- Ambjente të sigurta
- Orientim
- Promocion
- Identitet

Masterplani duhet të bazohet në ToR, ku në fillim të studiohet gjendja aktuale e zhvillimit të sistemit të ndricimit rrugor në bashki, kodet dhe standardet ekzistues dhe ato të Bashkimit Europian, rekomandimet e institucioneve ligjvënese dhe teknikat ndërkombetare , eksperiencia e vendeve ku janë aplikuar teknologjitë më të fundit të burimeve artificiale të ndricimit LED por edhe eksperiencia e vetë Bashkisë Tiranë në këtë fushë.

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Duke bërë krahasimet me teknologjinë më të përshtatshme për nevojat e Bashkisë Tiranë, bazuar në raportin çmim-efiçence, duke marrë në konsideratë gjithmonë gjëndjen aktuale sipas zonave (urbane-rurale).

1.1 Gjendja aktuale e sistemit të ndriçimit rrugor në Bashkinë Tiranë paraqitet:

Aktualisht Bashkia Tiranë nuk ka një masterplan të ndriçimit rrugor, nuk zbaton ndonjë standard/kod ndriçimi rrugor dhe nuk ka ndonjë klasifikim të rrugëve, mbi bazën e të cilit të kërkohet edhe një shkallë e caktuar ndriçimi. Deri më sot zhvillimi i ndriçimit rrugor është realizuar si pjesë e zhvillimit dhe rikonstruksionit të rrugëve dhe shesheve të qytetit.

Në këto kushte, në këtë studim, klasifikimi i rrugëve dhe vlerësimi i parametrave teknike e funksionale të sistemeve të ndriçimit rrugor që duhet realizuar duke u bazuar në standardin european EN 13201-4, kapitulli “CE-series of lighting classes”.

Bashkia Tiranë nuk ka llogaritje fotometrike të sistemeve të ndriçimit rrugor të instaluar në qytet. Për këtë arsye duhet të bëhen llogaritjet fotometrike me anë të softuere si “DiaLUX” ose të ngjashëm. Qëllimi i llogaritjes është të gjykohe mbi nivelin aktual të ndriçimit në këto rrugë bazuar në standartin EN 13201-2, si dhe llogaritjen e varianteve të ndryshme për të plotësuar parametrat e ndriçimit të kërkuar nga standarti me ndriçues LED të përshtatshëm sipas tipologjisë së rrugës

Aktualisht qyteti ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme të ndriçimit, ku kemi zona të cilat janë të mbindriçuara dhe zona të cilat janë të pandriçuara fare. Qëllimi i studimit është gjithashtu që të krijohet një plan ku të kemi një ndriçim të njëtrajtshëm, dhe të menjaherë maksimalisht fenomenin e “ndotjes nga ndriçimi” dhe hapësirave të pandriçuara duke e zhvilluar qytetin dhe duke i dhënë një identitet të ri.

Duhet që të gjykohe përdorimi i ndriçuesve për efekte dekorative siç janë ndriçuesit tip “glob” apo të ngjashëm me ta, të cilët e shpërndajnë ndriçimin në hapësirë.

Panelet elektrike që furnizojnë linjat e ndriçimit marrin ushqim nga kabinat lokale të OSHEE. Mbrojtja realizohet kryesisht me automate magneto termike ndërsa komandimi me një sistem automatik me rele muzgu-kontaktor/lëshues. Matja bëhet me matësa të instaluar kryesisht në Panelet elektrike nga OSHEE. Nga eksperiencat e Bashkisë Tiranë rezultojnë që matja në disa panele ka probleme në lidhje me mbifaturimin, faturim afrofe, dublimin apo ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit të operatorëve të tjerë. Nga inspektimi në vënd u vu re se në disa raste panelet elektrike të ndriçimit rrugor janë pa çelës.

Mbizotëron ndriçimi me llampa tradicionale me avuj merkuri dhe sodiumi në presonit të larte, HGI dhe SAP, me ngjyrë të verdhë. Duhet të inkorporohet inovacioni dhe teknologjia e re në hapësirat urbane dhe rurale që krijohen të reja, dhe të përmirësojë shërbimet egzistuese për qytetarët.

Për njësitë e reja administrative, krijuar mbas ndarjes së re administrative 2015, mungon

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

informacioni në lidhje me konsumin e energjisë nga rrjeti i ndriçimit. Në zonat periferike të Bashkisë Tiranë si dhe në njësitë e reja, furnizimi i rrjetit të ndriçimit është shpesh me linjë ajrore dhe cilësia e furnizimit me energji, le për të dëshiruar.

Në Bashkinë e Tiranës nuk ka një grafik tipik vjetor të konsumit të energjisë të nxjerrë sipas matjeve historike. Po kështu nuk disponohen studime mbi numrin e kalimtarëve apo makinave në orë të ndryshme të natës për të parashikuar një reduktim të fluksit të dritës.

Një sistem ndriçimi sipas teknologjive të fundit, është i rendësishem pasi lehtëson dhe ndihmojnë në lëvizjen e sigurtë të këmbësorëve dhe automjeteve, dekurajon veprimet e paligjshme, si dhe kontribuon në komoditetin e qytetit nëpërmjet një apeli të rritur estetik.

Objekt i projektit do të jetë hartimi dhe aprovimi i masterplanit të ndriçimit rrugor në Bashkinë Tiranë, duke mbajtur si reference standartin europian të ndriçimit EN 13201 si dhe rekomandimet e ndryshme në lidhje me objektin e detyrës së projektimit.

2. Kërkesat e projektit

Në këtë zonë, gjatë hartimit të Masterplanit të ndriçimit të rrugëve të Bashkisë Tiranë, të mbahen parasysh *Studimet Urbanistike Pjesore* (nëse ka), parashikimet e *Planit të Ri Rregullues dhe Masterplani i Transportit*. Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë, sipas *Rregullores së Urbanistikës* në fuqi ose 400 banorë/ha, si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonës/bllokut në fjalë.

1. Hartimin dhe aprovimin e masterplanit të ndriçimit rrugor, duke mbajtur si reference standartin europian të ndriçimit **EN 13201** dhe rekomandimet për specifikat e ndriçimit që do sugjerohet që nuk përfshihen në EN.
2. Studimi i infrastrukturës së ndriçimit në Bashkinë Tiranë ku potencialisht sistemet e ndriçimit mund të instalohen. Kryerja e një auditimi të hollësishëm të sistemit egzistues të ndriçimit dhe furnizimit me energji elektrike të rrugëve dhe hapësirave të përfshira në studim.
3. Përcaktimi i qartë i objektivave energjitike dhe teknike për tu arritur në projektet pilot duke u mbështetur në eksperiencën e bashkive të tjera në komunitetin evropian që kanë instaluar sisteme të ngjashme të ndriçimit rrugor .
4. Përcaktimi i fondit fillestar të investimit dhe kohës së vetshlyerjes.
5. Hartimi e një projekti dhe specifikimeve teknike paraprake për të përcaktuar sa më qartë karakteristikat e ndriçuesve në përputhje me shtyllat ekzistuese.
6. Identifikimi i tipit të ndriçuesit në bazë të rezultateve të projektit pilot dhe hartimi i planit përfundimtar afatshkurtër dhe afatmesëm për zhvillimin e sistemeve të ndriçimit rrugor me teknologjinë më të përshtatshme dhe eficiente.
7. Përcaktimi i procedurave të qarta të marrjes në dorëzim dhe mirëmbajtjes së sistemit të ri me teknologjinë përkatëse.
8. Hartimin dhe përcaktimin për ruajtjen e linjave ekzistuese në gjendje të mirë dhe

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

- ndërhyrje në linjat e amortizuar ekzistues të ndricimit publik + shtyllat
9. Hartimin dhe përcaktimi e masave për ndërhyrje për sigurimin teknik të rrjetit
 10. Hartimi dhe përcaktimi i një sistemi inteligjent ”Smart City” për monitorimin dhe komandimin e të gjitha pikave të ndricimit individualisht dhe në grupe.
 11. Kordimini i mbrojtjeve kryesore në panelet e furnizimit dhe pajisja e tyre me mbrojtje mbikqyje automatike.
 12. Paraqitja e gjendjes ekzistuese në GIS
 13. Informacioni i gjendjes egzistuese të përfshijë të gjithë faktorët që ndikojnë në cilësinë e ndricimit si : faktorët gjeografikë, p.sh; male, fusha, historia e ngarkesës, p.sh; të lehtë ose të ngarkuar rëndë, lidhja me furnizimin, p.sh. në linjat ajrore ose nëpërmjet kablllove nëntokësore, cdo histori e rinovimit, kushtet mjedisore dhe klimaterike të zonës, si dhe do karakteristikë tjetër të përshtatshme.
 14. Kategorizimi i rrugeve- standartizim i ndricimit për secilen kategori rruge
 15. Masterplani duhet të paraqesë qartë përmirësimin e standardeve të ndriçimit dhe rrijten e sigurisë.
 16. Ndarja sipas tipologjive të rrugeve (Urbane Kryesore, dytësore, lokale etj.)
 17. Standartizim dhe kategorizim i ndricimit në hapësirat publike (parqe, lulishte, kënde lojrash, fusha sportive etj...).
 18. Realizimi i një sistemi të centralizuar të menaxhimit (SCM), i cili siguron një sërë orarësh që mund të vendosen në përputhje me udhëzimet e projektimit të ndricimit, së bashku me një plan të detajuar se si duhet të reagojnë dritat, duke përfshirë:
 - Kur duhet të ndizet;
 - Kur duhet të errësohet dhe në çfarë niveli
 - Kur të fiket.
 19. Standartizim dhe kategorizim i ndricimit të godinave sipas tipologjisë së objekteve, (sipas figures 1)
 - Ndërtesa shtetërore
 - sipas tipologjisë,
 - rëndësisë
 - vendndodhjes (a.akse kryesore, b.qendër, c.periferi etj)
 - Ndërtesa private
 - Ndërtesa industriale
 - Objekte banimi
 - Zona /objekte komerciale
 - Zona/objekte të mbrojtura ose që janë pjesë e trashëgimisë kulturore
 - Zona/objekte historike

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”



Figura 1

3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të spostimeve të elementëve mbajtës të ndricuesve ose instalimi i elementëve të rinj si dhe të efijencës së ndërhyrjes, projektuesi duhet t'i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të projektit.

Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit, që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).

Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhenat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

3.1 Standartet

3.1.1 Standarte në projektim

Masterplani do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi dhe ai i BE-së. Masterplani duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi duhet të marrë në konsideratë dhe të përfshijë prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

3.1.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të masterplanit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Legjislacioni në fuqi.

3.2 Realizimi i projektit

Realizimi i masterplanit do të mbështetet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit:

- a- Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit.
- b- Analiza e thelluar e gjëndjes ekzistuese.
- c- Përmbledhja e vlerave dokumenteve.
- d- Relacionin e propozimeve.
- e- Llogaritja e vëllimit të punës dhe punimeve paraprake të nevojshme, p. sh. studime të parametrave aktuale të ndricimit, punime matjeje, kontrolli i tubacioneve dhe infrastrukturës kabllore ekzistuese ;
- f- Formulimi i ndihmave për vendimin për zgjedhjen e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- g- Planin e veprimeve, investimeve dhe projekteve për zbatimin e masterplanit.
- h- Vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e masterplanit
- i- Përmbledhja e rezultateve.

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (dwg, excel, word etj.)

FAZA II: Projekt ide paraprake

Caktimi i parametrave të ndricimit për secilen tipologji rruge dhe paraqitja e studimeve të ndryshme fotometrike, relacione, dokumenta të mbledhura për planifikimin dhe projektim e objektit duke përfshirë të gjitha vizatimet paraprake dhe dokumentacionin teknik.

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (dwg, excel, word etj.)

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

FAZA III: Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Skema elektrike përfundimtare të jetë e pasqyruar në planimetri, preventivi, relacionet, dokumenta të mbledhura për planifikimin dhe projektim e objektit duke përfshirë të gjitha vizatimet përfundimtare dhe dokumentacionin teknik.

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (dwg, excel, word etj.)

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë

për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Faza e projekt zbatimit duhet të përmbajë, dosjen e plotë të masterplanit të ndricimit të qytetit, me vizatimet teknike, relacionet teknike, grafikun e zbatimit të fazave të masterplanit, preventivin dhe analizat e kostove.

- a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve 3 dhe 4 (përgatitja hap pas hapi e zgjidhjes dhe e paraqitjes së saj) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.
- b) Paraqitje vizatimore dhe llogaritëse e objektit me të gjitha të dhënat e veçanta të nevojshme për zbatimin, përfshirë vizatime të detajuara në shkallët e kërkuara.
- c) Përpunimi i bazave për të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, dhe integrimi i kontributeve të tyre deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.
- d) Vazhdimi i planifikimit të zbatimit gjatë ndërtimit të objektit.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg., word, excel. Gjithashtu materiali duhet të dorëzohet dhe në sistemin GIS

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar.

- Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

të analizave teknike të tyre”.

- Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë preventiv, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.
- Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.
- Preventivi do të hartohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia e Tiranës.

4. Rekomandime për projektuesin

- a) Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues.
- b) Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake, që disponohen nga Bashkia e Tiranës, dhe Ndërmarrjet në varësi. Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe standarte të ndryshme, që ka nxjerrë Bashkia e Tiranës, siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.
- c) Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë, që të arrihet në standartin e kërkuar.

4.1 Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar:

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës. Stafi, që kërkohet duhet të përfshijë:

1. Projektues rruge;
2. Inxhinier topograf;
3. Inxhinier elektrik;
4. Staf mbështetës për fushat e mësipërme
5. Projektues instalator
6. Projektues urbanist
7. Inxhinier elektronik
8. Specialist i GIS-it
9. Projektues Arkitekt
10. Dizenjues profesional të ndriçimit
11. Projektues të sinjalizimit rrugor
12. Ekspert për efikasitet energjie
13. Ekspert Kontabël
14. Inxhinier elektrik për automatizim
15. Projektues konstruktor

5. Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 5 (pesë) kopje, në format soft copy dhe hard copy dhe 5 (pesë) kopje në CD. Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar, i cili transferohet në GIS. Një nga këto kopje do të nevojitet për aplikim përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit.

Në rast se projekti do të duhet t'i nënshtrohet Këshillave Teknike të tjera, të cilat zhvillohen nga Institucionet përkatëse, do të nevojitet nga një kopje e plotë shtesë fizike dhe elektronike e

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

projektit nga firma projektuese, për prezantim dhe miratim në këto Këshille.

6. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

1. Horografia
2. Topografinë e gjendjes ekzistuese, në të cilën të jenë të azhornuara në gjendjen e sotme në Shk. 1:500 ose 1:1000;
3. Planimetria e gjendjes ekzistuese të ndriçimit
4. Analiza e gjendjes ekzistuese
5. Analiza e ndryshimeve të projektit të ri
6. Një plan koncept ku detajohen zonat sipas rëndësisë dhe ndriçimit
7. Planimetria e ndriçimit rrugor dhe detaje të ndriçimit rrugor në Shk. 1:500 ose 1:1000;
8. Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

7. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Punëve Publike, Bashkia Tiranë.

8. Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.

Ne hartimin e preventivit duhet të mbahen parasysh çmimet e referencës për njësi sipas Manualit teknik të çmimeve në fuqi

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Ortofoto Bashkise Tiranë



“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Shtojca 16

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 17

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

“Studim Masterplane ndriçimit të Qytetit”

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
